



Duke u mbështetur në nenin 17 pika nën r) nenit 40 paragrafi 2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 40 alinea 2 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 5 pika 4, nenit 10, nenit 12 dhe 17 nën pikën 3 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të Komunës së Klinës me Kërkesën e Drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sport më rekomandimet e KPF të dt.13.02.2017, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të rregullt për vitin 2017, të mbajtur më 24.02.2017, miratoi këtë :

V E N D I M

Për

Subvencionimin e Klubeve Sportive "Dukagjini" të Klinës

- I. Miratohet Vendimi për Subvencionimin e OJQ publike -Klubeve Sportive "Dukagjini" në Klinë për vitin 2017.

Subvencionimi i Klubeve behët si në vijim:

1. Klubi i Futbollit "Dukagjini" për meshkuj -30.000€
 2. Klubi i Futbollit "Dukagjini" për femra-5000€
 3. Klubi i Volejbollit "Dukagjini" për femra -4000€
 4. Klubi i Hendbollit "Dukagjini" për meshkuj -3000€
- II. Për ekzekutimin e këtij vendimi kompetent është Kryetari i Komunës me Drejtorinë e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- III. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në Web faqen e Komunës konform nenit 18 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/2013.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra për Informim, një kopje për Dosje dhe një për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-958 2017
Klinë, më 01.03 2017

